

AKTIVITETE NË QENDRAT E SHËRBIMIT TË NDIHMËS JURIDIKE PARËSORE, ME PREZENCËN E DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM TË DNJF, Z.ERGYS QIRICI

Gjirokastrë

Drejtori i Përgjithshëm i DNJF, z. Ergys Qirici mori pjesë në aktivitetin, në kuadër të Projektit "Avancimi i shërbimeve elektronike të drejtësisë për fuqizimin ligjor dhe akses të përmirësuar në drejtësi të grave dhe burrave në Shqipëri-E-justice.

Kukës

Takim i organizuar në kuadër të "Ditës Ndërkombëtare të Familjes", me përfaqësues të institucioneve në nivel lokal Bashkia, Kukës.

Fier

Në datën 09.05.2024, në kuadër të javës Europiane, Drejtori i Përgjithshëm, zhvilloi takim pranë QSHNJP Fier, në bashkëpunim me përfaqësuesen e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi Zyra Rajonale Fier.

Pogradec

Në datën 28.05.2024, Drejtori i Përgjithshëm mori pjesë në aktivitetin me përfaqësues të institucioneve në nivel lokal Bashkia, Pogradec.

Berat

Në datën 23.05.2024, Drejtori i Përgjithshëm z. Ergys Qirici mori pjesë në aktivitetin me përfaqësues të institucioneve në nivel lokal, Bashkia Berat.


ANAD (Shoqata Kombëtare Shqiptare e Njerëzve që nuk Dëgjojnë) & Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas, në kuadër të projektit "Rritja e kapaciteteve të komuniteti të njerëzve që nuk Dëgjojnë për Akses falas, në shërbimet e ndihmës juridike nëpërmjet informacionit në gjuhën e shënjave".

Tiranë

Fier

Shkodër

 **QSHNJP Fier** në datën 03.05.2024 organizoi një aktivitet në Bashkinë Divjakë, të zhvilluar në kuadër të objektivit për vitin 2024, për të zhvilluar 1 ditë të hapur edukimi ligjor/sensibilizimi, në çdo bashki për Qark.



 **QSHNJP Fier** në datën 07.05.2024 mori pjesë në një aktivitet të zhvilluar nga Bashkia Fier me mbështetjen e UNDP, për përgatitjen e Planit Vendor të Kujdesit dhe Përfshirjes Sociale (PVKPS) 2024 – 2026.

 **QSHNJP Fier** në datën 09.05.2024 mori pjesë në një aktivitet të zhvilluar nga Prefektura e Qarkut Fier, në kuadër të ditës Kombëtare të Drejtësisë.

 **QSHNJP Fier** në datën 09.05.2024, në kuadër të ditës Ndërkombëtare të Familjes, mori pjesë në një takim të Ekipit Teknik Ndersektorial (ETN), të zhvilluar nga Drejtoria e Shërbimit Social, Bashkia Fier.



 **QSHNJP Vlorë** në datën 07.05.2024 organizoi pranë selisë së Shoqatës së të Verbërve Vlorë, një takim edukimi ligjor me kategorinë e veçantë të ligjit nr.111/2017, me personat që përfitojnë nga pagesa e verbërisë, ku ishin të pranishëm 7 persona që i përkisnin kësaj kategorie.

 **QSHNJP Vlorë** në datën 08.05.2024, në kuadër të nismës së DNJF-së për Ditët e Hapura në Bashkitë e vogla të Qarkut Vlorë, organizoi një aktivitet me Kryetaren e Bashkisë Himarë, zj. B.Bala dhe përfaqësues të tjerë të kësaj Bashkie.




 **QSHNJP Vlorë** në datën 10.05.2024, mori pjesë në panelin e ditës së dytë të Shkollës Pranverore, me ftesë nga Këndi i BE, Bashkia Vlorë, me temë *"Përditësimi i shërbimeve në nivel lokal për të rinjtë dhe kontributi i tyre në komunitet"*.

 **QSHNJP Vlorë** në datën 14.05.2024, zhvilloi një takim, në kuadër të Ditës së Familjes, në Njësine Administrative Novoselë, me gra dhe vajza banore të Njesisë, që i përkasin komunitetit Rom dhe Egjiptian.



 **QSHNJP Vlorë** në datën 17.05.2024, zhvilloi një leksion të hapur me studentët e Universitetit të Vlorës *"Ismail Qemali"*, Fakulteti i Drejtësisë. Riaktivizimi i Klinikës së Ligjit, e cila prej 3 vjetësh nuk funksionon pranë këtij Universiteti.

 **QSHNJP Vlorë** në datën 20.05.2024, në bashkëpunim me Zyrën e Avokatit të Popullit Vlorë dhe Bashkisë Vlorë zhvilloi një Konkurs midis nxënësve të gjimnazit *"Halim Xhelo"* Vlorë.



 **QSHNJP Lezhë** në datën 15.05.2024, mori pjesë tek Panairi i shërbimeve sociale, organizuar pranë qendrës *"Fuqizojmë Komunitetin"*, si një mundësi informimi mbi shërbimet që ofrohen pranë qendrave sociale.

 **QSHNJP Lezhë** në datën 22.05.2024 mori pjesë në takimin e organizuar nga Kryetari i shoqatës së të Verbërve, dega Lezhë, ku u prezantua Manuali për Ndhmën Juridike, në gjuhën Braille.



 **QSHNJP Lezhë** në datën 20.05.2024 zhvilloi një takim pranë Drejtorisë së Shërbimit Social, Bashkia Lezhë, ku moren pjesë zj. S.Qevani, Përgjegjëse Sektori pranë DNJF, si dhe përfaqësues të tjerë të Bashkisë.



 **QSHNJP Kurbin** në datën 10.05.2024, në kuadër të Datës 10 Maj Ditës së Drejtësisë, zhvilloi një takim pranë Njesisë Administrative Mamurras, me administratorin i kësaj njësie z.E.Tafaj, Nënkryetarin e Bashkisë Kurbin, si dhe përfaqësues të tjerë të bashkisë.

 **QSHNJP Kurbin** në datën 20.05.2024, zhvilloi një takim në kuadër të ecures së veprimtarisë të Qendrës, ku pjesëmarrës ishin përfaqësues të Bashkisë Kurbin, si dhe përfaqësues nga Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas.





📍 **QSHNJP Përmet** në datën 09.05.2024, në ditën e Europës u angazhua në shpërndarjen e fletëpalosjeve si dhe informimit të qytetarëve, në aktivitetin e zhvilluar nga Bashkia Përmet.

📍 **QSHNJP Përmet** në datën 17.05.2024, mori pjesë në aktivitetin për të drejtat e fëmijëve dhe të rinjve në botën dixhitale, organizuar nga Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike dhe Agjensia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve.



📍 **QSHNJP Përmet** në datën 17.05.2024, mori pjesë në prezantimin e projektit "LegalTech Access Initiative" në ambjentet e Universitetit "Eqrem Çabej".

📍 **QSHNJP Përmet** në datën 17.05.2024, zhvilloi një takim për prezantimin e manualit "Si të përfitojmë ndihmë juridike falas" në gjuhën Braille, me Kryetarin e shoqatës së të verbërve Z.P.Nikollari dhe me persona të kësaj kategorie të veçantë të ligjit.



📍 **QSHNJP Kavajë** në datën 07.05.2024 dhe 15.05.2024, zhvilloi aktivitetin "Street Law", me qëllim informimin e qytetarëve.

📍 **QSHNJP Kavajë** në datën 10.05.2024, zhvilloi një takim, në bashkëpunim me ZVA Kavajë, stafin dhe nxënës të gjimnazit "A.Moisiu", Kavajë.

📍 **QSHNJP Kavajë** në datën 24.05.2024, zhvilloi një takim për prezantimin e manualit "Si të përfitojmë ndihmë juridike falas" në gjuhën Braille, me Shoqatën e të Verbërve, Kavajë

📍 **QSHNJP Kavajë** në datën 28.05.2024, zhvilloi një takim në bashkëpunim me shoqatën "TLAS", me temë "Prezantimi i përdorimit online të shërbimeve të ndihmës juridike falas".



📍 **QSHNJP Elbasan** në datën 03.05.2024, zhvilloi një takim për prezantimin e manualit "Si të përfitojmë ndihmë juridike falas" në gjuhën Braille, me Shoqatën e të Verbërve, Elbasan.



📍 **QSHNJP Elbasan** në datën 10.05.2024, Ditën Kombëtare të Drejtësisë, zhvilloi një "Sesion informimi street law", me qytetarët, në kuadër të ndërgjegjësimit dhe informimit mbi Ligjin Nr.111/2017 "Për Ndihmën Juridike të Garantuar nga Shteti".

📍 **QSHNJP Elbasan** në datën 22.05.2024, zhvilloi një aktivitet me Shoqatën e Paratetraplegjikëve.

📍 **QSHNJP Elbasan** në datën 23.05.2024, zhvilloi një aktivitet në Bashkinë Prrenjas, me pjesëmarrjen e kategorive përfituese të ligjit.




📍 **QSHNJP Korçë** në datën 10.05.2024, Ditën Kombëtare të Drejtësisë, mori pjesë në takimin e realizuar nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, me pjesëmarrjen e nxënësve të shkollës së mesmë të përgjithshme "Raqi Qirinxhi".

📍 **QSHNJP Korçë** në datën 13.05.2024, realizoi një takim me përfaqësues të Bashkisë Kolonjë.

📍 **QSHNJP Korçë** në datën 15.05.2024, në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Familjes, realizoi një takim me qytetarë, ku u diskutua për përforcimin dhe ndërgjegjësimin për çështjet shoqërore, ekonomike, sociale që prekin familjen.

📍 **QSHNJP Korçë** në datën 17.05.2024, zhvilloi një takim për prezantimin e manualit "Si të përfitojmë ndihmë juridike falas" në gjuhën Braille, me përfaqësues të Shoqatës së të Verbërve.



📍 **QSHNJP Korçë** në datën 28.05.2024, mori pjesë në takimin konsultativ, në kuadër të procesit të monitorimit të Planit Kombëtar të Veprimit për PAK 2021-2025.

📍 **QSHNJP Mat**, gjatë muajit Maj 2024, ka zhvilluar në total 6 aktivitete:

Datë 02.05.2024, një takim sensibilizues në kuadër të 1Majit, Ditës Ndërkombëtare të Punëtorëve.

Datë 07.05.2024, një aktivitet bashkëpunues me Shoqatën për mbrojtjen e të drejtave të verbërve, Mat.

Datë 09.05.2024, një aktivitet "Street law", pranë terminalit të autobusëve të fshatrave, Mat.

Datë 15.05.2024, një aktivitet në kuadër të Ditës ndërkombëtare të familjes.

Datë 20.05.2024, një aktivitet "Street law", pranë pazarit të rrobave të përdorura;

Datë 22.05.2024, një aktivitet "Street law", në sheshin "Ahmet Zogu", Mat.



QSHNJP Berat në datën 08.05.2024, zhvilloi një takim për prezantimin e manualit *"Si të përfitojmë ndihmë juridike falas"* në gjuhën Braille, me Kryetarin e Shoqatës së të Verbërve, Berat z.Y.Agalliu dhe qytetarë përfitues nga Statusi i Verbërisë.

QSHNJP Berat në datën 15.05.2024, zhvilloi një takim informues në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Familjes.

QSHNJP Berat në datën 23.05.2024, zhvilloi një takim me pjesëmarrjen e Drejtorit të Përgjithshëm Z.Ergys Qirici, me pushtetin lokal, Berat.




QSHNJP Berat në datën 27.05.2024, zhvilloi një takim me përfaqësuesen e Zyrës Rajonale të Avokatit të Popullit Berat Zj.Lira Tuta.

QSHNJP Berat në datën 29.05.2024, zhvilloi një aktivitet informues/ndërgjegjëses, në bashkëpunim me Zyrën Rajonale të Avokatit të Popullit Berat, me Drejtoreshën e Qendrës Polivalente, Bashkia Poliçan.



QSHNJP Gjirokastrë në datën 09.05.2024, mori pjesë në aktivitetin e zhvilluar nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastrë, në kuadër të ditës Kombëtare të Drejtësisë.

QSHNJP Gjirokastrë në datën 22.05.2024, mori pjesë në aktivitetin për prezantimin e projektit *"LegalTech Access Initiative"*, zhvilluar në ambientet e Universiteti *"Eqrem Çabej"*.



QSHNJP Gjirokastrë në datën 23.05.2024, realizoi një intervistë me median lokale RTGJ, e zhvilluar në ambientet e Qendrës. <https://youtu.be/15Q19-dg-xc?si=dBEmGihOoBv4LIZM>

QSHNJP Gjirokastrë në datën 28.05.2024, zhvilloi një takim për prezantimin e manualit *"Si të përfitojmë ndihmë juridike falas"* në gjuhën Braille, ku morën pjesë Kryetari i personave me aftësi të kufizuar, Kryetari i të verbërve, si dhe qytetarë, në ambientet e Këshillit të Qarkut Gjirokastrë.

QSHNJP Pogradec në datën 09.05.2024, në kuadër të Ditës Ndërkombëtare e Familjes, organizoi një takim me nxënës të shkollës 9 vjeçare *"Servet Agolli"*, Njësia Administrative Buçimas.



QSHNJP Pogradec në datën 10.05.2024, në kuadër të Ditës Kombëtare të Drejtësisë ka organizuar një sesion informimi *"Street law"* me qëllim ndërgjegjësimin dhe informimin mbi ndihmën juridike të garantuar nga shteti.

QSHNJP Pogradec në datën 10.05.2024, në bashkëpunim me Avokaten e Popullit, Pogradec organizoi një takim për prezantimin e manualit *"Si të përfitojmë ndihmë juridike falas"*, në gjuhën Braille, me përfaqësues nga Shoqata e të Verbërve Pogradec dhe Kryetarin e Shoqatës së personave PAK e antarë të kësaj shoqate.



QSHNJP Pogradec në datën 28.05.2024 organizoi një aktivitet me përfaqësues të institucioneve në nivel lokal, Bashkia Pogradec. Në këtë takim mori pjesë Drejtori i Përgjithshëm i DNJF, z.Ergys Qirici.



QSHNJP Shkodër në datën 10.05.2024, në kuadër të Ditës së Drejtësisë, organizoi një sesion informimi *"Street law"* me qytetarët e qytetit Koplik, Malësi e Madhe.

QSHNJP Shkodër në datën 15.05.2024, në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Familjes, zhvilloi një takim në ambientet e Shtëpisë Familje (16-18).

QSHNJP Shkodër organizoi një aktivitet në datën 27.05.2024 në kuadër të projektit *"Qasja gjithëpërfshirëse për të garantuar akses të barabartë në drejtësi për personat me aftësi të kufizuar në Shqipëri"*, me pjesëmarrjen e Drejtorit të Përgjithshëm të DNJF, z.Ergys Qirici.



QSHNJP Shkodër, në datën 27.05.2024 mori pjesë në aktivitetin e organizuar nga Shërbimi Social Shtetëror, Shkodër, në kuadër të procesit të monitorimit të Planit Kombëtar të Veprimit për PAK 2021-2025, MSHMS.

QSHNJP Kukës, në datën 02.05.2024 zhvilloi një takim në Njësia Administrative Shtiqen, me punonjës të këtij insititucioni në kuadër të bashkëpunimit ndërinstitutional.

 **QSHNJP Kukës**, në kuadër të Ditës Kombëtare të Drejtësisë, realizoi një takim informues brenda ambienteve të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës, me punonjës të këtij institucioni.



 **QSHNJP Kukës**, në datën 10.05.2024 zhvilloi një takim pranë ambienteve të Shoqatës së të Verbërve Kukës, me kryetarin Z.A.Qenanaj, për prezantimin e manualit *"Si të përfitojmë ndihmë juridike falas"*, në gjuhën Braille.

 **QSHNJP Kukës**, në datën 13.05.2024 zhvilloi një takim me Koordinatorën për Dhunën në Familje dhe Juristen Zj.J.Halilie, në Drejtorinë Vendore të Policisë Kukës, në kuadër të bashkëpunimit ndërinstitutional.



 **QSHNJP Kukës**, në datën 14.05.2024 mori pjesë në takimin e zhvilluar nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KShH) për të konsultuar gjetjet dhe disa rekomandime të adresuara të draft raportit studimor të hartuar.


 **QSHNJP Kukës**, në datën 15.05.2024 organizoi një takim në kuadër të *"Ditës Ndërkombëtare të Familjes"*, në ambientet e Pallatit të Kulturës *"Hasan Prishtina"*, me pjesëmarrjen e Drejtorit të Përgjithshëm të DNJF, z.Ergys Qirici.

 **QSHNJP Kukës**, në datën 17.05.2024 organizoi një takim me punonjës të Qendrës Shëndetësore Bica, si dhe me qytetarë të kesaj Njësie Administrative.

 **QSHNJP Kukës**, në datën 17.05.2024 organizoi një takim pranë Qendrës Shëndetësore Ujmisht, si dhe me punonjës të Njesisë Administrative Ujmisht.

 **QSHNJP Lushnjë** mori pjesë në aktivitetin e zhvilluar nga Njësia e Integritimit Evropian, në kuadër të Ditës së Familjes, me pjesëmarrjen e gjimnazistëve, të shoqëruar nga psikologë dhe mësues.

 **QSHNJP Lushnjë** zhvilloi në datën 16.05.2024 një takim me temë "Ditë e hapur bashkëbisedimi institucional", me Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Fier dhe Avokatin e Popullit, Berat.



 **QSHNJP Lushnjë**, në datën 10.05.2024 zhvilloi një takim me anëtare të komunitetit të personave që nuk shikojnë, për prezantimin e manualit *"Si të përfitojmë ndihmë juridike falas"*, në gjuhën Braille.



 **QSHNJP Tropojë** zhvilloi në datën 17.05.2024 një takim informues me qytetarë që i përkasin komunitetit rom/egjiptian.

 **QSHNJP Tropojë**, në datën 27.05.2024 zhvilloi një takim me Kryetarin dhe Sekretarin e Shoqatës së të Verbërve Tropojë, për prezantimin e manualit *"Si të përfitojmë ndihmë juridike falas"*, në gjuhën Braille.

 **QSHNJP Tropojë**, në datën 30.05.2024 organizoi një takim promovues me nxënës dhe mësues të shkollës 9-vjeçare të fshatit Babinë, Njësia Administrative Tropojë.



 **QSHNJP Durrës dhe Kavajë**, në datën 02.05.2024 zhvilluan një aktivitet me kategorinë e veçantë përfituese të ligjit "Viktimat e Dhunës në Familje" dhe "Persona përfitues të mbrojtjes së skemave sociale", në bashkëpunim me Shoqatën Gender Paqe dhe Siguri.

 **QSHNJP Durrës** në datën 09.05.2024 zhvilloi në kuadër të ditëve të hapura në bashkitë e vogla, një aktivitet informues në ambjentet Bashkisë Krujë.



 **QSHNJP Durrës**, në datën 14.05.2024 mori pjesë në takimin e zhvilluar nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KShH) për të konsultuar gjetjet dhe disa rekomandime të adresuara të draft raportit studimor të hartuar.

 **QSHNJP Durrës**, në datën 17.05.2024 në bashkëpunim me studentet e Universitetit "Epoka" ka organizuar një sesion informimi "Street Law".

 **QSHNJP Durrës dhe Kavajë**, në datën 02.05.2024 zhvilluan një aktivitet, në kuadër të bashkëpunimit me Klinikën Ligjore pranë Universitetit "Aleksandër Moisiu", me studentet e këtij Universiteti.

 **QSHNJP Pukë**, në datën 29.05.2024 zhvilloi një takim me Kryetarin dhe anëtarin e Shoqatës së të Verbërve Pukë, për prezantimin e manualit *"Si të përfitojmë ndihmë juridike falas"*, në gjuhën Braille.

 **QSHNJP Pukë**, në datën 07.05.2024 zhvilloi dy aktivitete me perfaqesues të Bashkisë Puke, dhe UNDP, si dhe takimin me Shoqërinë Civile.

 **QSHNJP Pukë**, në datën 07.05.2024 zhvilloi sesionin informues "Street Law" dhe shpërndarjen e fletë-palosjeve, si dhe afishimin e posterave në vende publike.

